



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 675/5 prot.

Tiranë, më 14.12.2020

VENDIM
Nr.180, datë 14.12.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 123, DATË 14.10.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 123, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar nëpërmjet kërkesës së punonjësës së Bashkisë Kolonjë, *****, për parregullsi të pretenduara se janë kryer në procedurën e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit”*.

KONSTATOVA SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 514 prot., datë 8.6.2020, punonjësja ***** ka parashtruar pretendimet e saj për parregullsi të kryera gjatë procedurës së transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Kolonjë të dërgojë gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me procesin e transferimit të nëpunësës.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin nr.123, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar nëpërmjet kërkesës së punonjësës së Bashkisë Kolonjë, *****, për parregullsi të pretenduara se janë kryer në procedurën e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kolonjë, me shkresën nr. 4923/1 prot., datë 5.11.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin dhe në

pjesën arsyetuese të vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Kolonjë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, institucioni, me Urdhrin nr. 530, datë 20.10.2020, ka revokuar aktin nr.32, datë 18.5.2020, *“Për transferimin e përhershëm të *****”*. Referuar Relacionit nr. 5059 prot., datë 23.10.2020, Komisioni i Ristrukturimit ka rishqyrtuar rastin dhe në pamundësi për ta sistemuar në një pozicion tjetër brenda sistemit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunëse, marrëdhënie e cila ka përfunduar me Vendimin nr. 72, datë 26.10.2020, të Bashkisë Kolonjë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 123, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar nëpërmjet kërkesës së punonjësës së Bashkisë Kolonjë, *****, për parregullsi të pretenduara se janë kryer në procedurën e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Kolonjë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 123, datë 14.10.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kolonjë dhe nëpunësja *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha